



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:026233

Datë: 15.05.2019

Numri i dokumentit: 00313749

P.nr.179/16

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, ne lenden penale PP.II.nr.3163/15 te dt.29.02.2016, ndaj të pandehurit G. G. nga Suhareka, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 3 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit te PTH-së nga Prizreni Shpend Binaj dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, te mbajtur me dt.07.05.2019 mori, publikisht shpalli dhe me date 15.05.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit G. G. nga i ati S. dhe e ëma A. te vajzërisë J., i lindur më 21.07.1970 në Suharekë ku dhe tani jeton Rr. Z. B. nr., me numër, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, me pare i pa dënuar, shqiptar shtetasi Republikës se Kosovës.

Në bazë të nenit 363 pika 1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse me dt. 30.09.2015 rreth orës 02.:30 minuta, në motelin “F.” në Suharekë, me dashje përdor forcën ndaj te dëmtuarës V. K., me të cilën ishte ne lidhje-partner, në atë mënyrë qe pasi shkojnë ne motelin:”F. “pas një mosmarrëveshje mes tyre, i pandehuri e godet me shuplakë ne fytyrë pa dashjen e saj, por nuk i shkakton lëndime trupore.

Me çka kishte për të kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 3 te Kodit Penal.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

PTH. në Prizren me aktakuzën **PP.II.nr.3163/15 te dt.29.02.2016**, ndaj të pandehurit G. G. nga Suhareka, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 3 i Kodit Penal, aktakuzën të cilën gjate shqyrtimit gjyqësor, e ka përfaqësuar PSH ne Prizren Shpend Binaj, i cili në funde të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga akuza.

Meqenëse Prokurori i Shtetit ka hequr dorë nga akuza në fund të shqyrtimit gjyqësor, gjykata konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në përputhje me nenin 454 par.1 të KPP-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:026233
Datë: 15.05.2019
Numri i dokumentit: 00313749